



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 17 shkurt 2025, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII,

E mbajtur për nderë të 17 shkurtit - Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Mbledhja filloi në orën 10;25, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

(Nga LDK, para se të fillonte mbledhja ishin prezent dhe u nënshkruan në Listën e pjesëmarrjes anëtarët/et si në vijim, mirëpo para se të fillonte mbledhja lëshuan sallën dhe nuk morën pjesë:

Amisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani, Fatmir Gashi.

Nga LVV, prezent ishin: Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Xhevdet Maloku; Haki Rudari.

Nga AAK, prezent ishin: Arbnor Fazliu, Mrika Thaqi.

Gjithashtu i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS, Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR, Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.)

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë – Himni Kombëtar

- **Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

z.Hilmi Hoxha, e hapi mbledhjen duke i'u dëshiruar të pranishmëve mirëseardhje në këtë mbledhje Solemne për nder të 17 Shkurtit-Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në vazhdim theksoi, i nderuari Kryetar i Komunës së Podujevës z.Shpejtim Bulliqi, e nderuara Nënkryetare e Komunës znj.Marigona Lahu, të nderuar anëtar e anëtare të Kuvendit të Komunës, drejtorë e drejtoresha të Drejtorive të Ekzekutivit të Komunës, të respektuara dhe shumë të nderuara familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës, përfaqësues të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, të nderuar përfaqësues të institucioneve dhe qytetarë të Komunës së Podujevës.

Jemi mbledhur sot këtu për të shënuar përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës, këtë datë shumë të veçantë dhe të shumëpritur. Në nderim të të gjithë Dëshmorëve dhe të rënëve të Kombit për liri, ju ftoj për 1 minutë nderimin (heshtje).

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të të gjithë Dëshmorëve dhe të të rënëve për liri. Lavdi

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, sot në këtë ditë të shënuar, mblidhemi për festuar dhe nderuar Pavarësinë e Kosovës, një ngjaje historike që shënoj një kthesë të rëndësishme në jetën e popullit tonë dhe të shtetit tonë të ri.

Si Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës, për mua është një nderë i madh të flas në emër të këtij qyteti që dha shumë për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.

17 shkurti i vitit 2008 është një ditë që mbetet e shkruar me germa të arta në historinë e Kombit tonë, ky është një përvjetor që na e kujton Pavarësinë e cila nuk ka ardhur lehtë por si rezultat të përpjekjes së jashtëzakonshme të një lufte të lavdishme dhe të sakrificave të mëdha. Kosova shpalli Pavarësinë pas një periudhe të gjatë e të mundimshme dhe vuajtje por që asnjëherë nuk humbi besimin se shpresa për një jetë dhe një të ardhme më të mirë.

Sot kur festojmë Pavarësinë, le të kujtojmë ata që dhanë gjithçka për të na e mundësuar që ne të jetojmë në një shtet të lirë dhe të pavarur, ata janë ata që bënë të mundur që Podujeva dhe Kosova të jenë pjesë e familjes ndërkombëtare të shteteve të lira dhe të pavarura, në këtë ditë të shënuar u themi atyre faleminderit, por përveç festës, ky është një moment reflektimi dhe angazhimi të gjithë secilit prej nesh.

Pavarësia është një arritje e madhe por ajo është një gjithçka për ne në përgjithësi, si qytetarë të Kosovës dhe si përfaqësues të Komunës së Podujevës duhet të punojmë çdo ditë për ta përforcuar këtë Pavarësi, për të krijuar mundësi për zhvillim dhe për të siguruar që çdo qytetarë të ketë një jetë të dinjitetshme, për t'u kujdesur për të rinjtë tanë dhe për të siguruar që Kosova të jetë shtet i fortë, i drejtë dhe i begatshëm.

Urime përvjetori i Pavarësisë së Kosovës.

Ju faleminderit.

- **Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës**

z.Shpejtim Bulliqi, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit z.Hilmi Hoxha, të nderuar drejtorë/sha të Drejtorive Komunale, të nderuar asambleistë/e të Kuvendit të Komunës, Shoqata të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuara media dhe mysafir të pranishëm.

Sot në këtë ditë të shënuar jemi mbledhur në Kuvendin e Komunës për të shënuar me seancë solemne 17 vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Kjo është një ditë historike, një ditë që na kujton sakrificat, mundin dhe përpjekjet e mëdha të brezave të tërë për lirinë dhe shtetësinë tonë.

Më 17 shkurt të vitit 2008 Kosova realizoj ëndrrën shekullore të popullit të saj, Shpalljen e Pavarësisë. Ky akt nuk ishte vetëm një moment politik apo një vendim institucional, por ishte një kulmim i një rruge të gjatë të mbushur me përpjekje, qëndresë dhe sakrificë.

Pavarësia e Kosovës është fryt i sakrificës së mijërave Dëshmorëve dhe Martirëve, i luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mbështetjes së aleatëve tanë ndërkombëtarë në rrugëtimin tonë për liri dhe pavarësi.

Nuk mund të kujtojmë dit, pa përmendur edhe figurat emblematike të rezistencës dhe udhëheqjes tonë Kombëtare si Presidentin historik Dr.Ibrahim Rugova, Komandantin Legjendar Adem Jashari, Komandantin Zahir Pajaziti, dhe shumë të tjerë që me veprën dhe vizionin e tyre i dhanë drejtim çlirimtar dhe shtet ndërtimit.

Të nderuar të pranishëm, 17 vite pas shpalljes së Pavarësisë, Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në konsolidimin e institucioneve demokratike, zhvillimin ekonomik dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar.

Ne sot jemi një shtet i njohur nga më shumë se 100 shtete të botës, një shoqëri që po zhvillohet dhe po integrohet në instancat demokratike të botës bashkëkohore.

Megjithatë rruga jonë përpara mbetet e mbushur me shumë sfida, zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, arsimi, mirëqenie sociale janë fusha ku duhet të vazhdojmë të punojmë me përkushtim të madh për ta forcuar shtetin e zhvilluar edhe shoqërinë.

Në këtë përvjetor ne reflektojmë për atë që kemi arritur dhe marrim obligime se për çka duhet të angazhohemi më tej në të ardhmen.

Kosova është amanet i Dëshmorëve dhe përgjegjësi e jona e përbashkët për ta forcuar dhe zhvilluar, Pavarësia nuk është vetëm një datë historike por një angazhim i vazhdueshëm për institucione të forta, drejtësi dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët tanë.

Sot më shumë se kurrë na duhet uniteti dhe përkushtimi për ta bërë Kosovën një vend ku rinia ka perspektivë, ku sundon ligji dhe ku secili ndihet krenar për shtetin e tij.

Lavdi Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit, respekt dhe nderim të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Urime të gjithëve 17 vjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar Kryetarin e Komunës për fjalimin, theksoi, edhe njëherë urime për të gjithë 17 shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës.

Para se të përfundojmë me këtë mbledhje solemne, ju ftojme për pjesëmarrje në vendosjen e kurorave me lule pran Shtatoreve të Ali Ajetit, Adem Demaçit dhe Shtatores së katër Dëshmorëve ku do të vazhdojmë në varrezat në fshatin Penuh.

Ju faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në seancat e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora 10:35

Procesverbalin e mbajti;

Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0010581/25

Podujevë, 17 shkurt 2025

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha